

Statistika të diplomimeve, 2023-2024

Tiranë, më 12 Maj 2025 : Ky publikim paraqet statistika të diplomimeve të nxënësve dhe studentëve në arsimin zyrtar në Shqipëri, si në institucionet arsimore publike dhe ato private.

- Në vitin shkollor 2023-24, u diplomuan në arsimin zyrtar 82.712 nxënës dhe studentë:
 - 33,5 % në arsimin 9 vjeçar;
 - 32,3 % në arsimin e mesëm të lartë;
 - 0,1 % në arsimin pas të mesëm jo të lartë;
 - 34,1 % në arsimin e lartë.
- Në arsimin 9-vjeçar, nga 27.705 të diplomuar, 51,4% ishin meshkuj dhe 48,6% femra.
- Në arsimin e mesëm të lartë, u diplomuan 26.729 të diplomuar, 1.3 % më pak, krahasuar me vitin e kaluar akademik.
- Në arsimin e mesëm të lartë profesional, nga 3.174 të diplomuar, 82,7% ishin meshkuj dhe 17,3% femra.
- Në vitin akademik 2023-2024, nga 28.193 studentë të diplomuar në arsimin e lartë, 65,8% ishin studente femra.
- Fusha "Biznes, administrim dhe ligj" është më e preferuara për femrat, me 25,9% të të diplomuarave femra.
- Fusha "Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim" është më e preferuar nga meshkujt, me 25,2% të të diplomuarave meshkuj.


Për publikim: 12/05/2025

Arsimi parauniversitar

Në vitin shkollor 2023-2024 në arsimin 9-vjeçar u diplomuan 27.705 nxënës, nga të cilët 51,4 % ishin meshkuj dhe 48,6 % femra. Në arsimin e mesëm të lartë u diplomuan 26.729 nxënës, ku, 3.174 nxënës ishin të diplomuar në arsimin e mesëm profesional, me dominancë meshkuj me 82,7 %. Të diplomuarit e arsimit të mesëm të lartë profesional përbëjnë 11,9 % të të diplomuarve gjithsej në arsimin e mesëm të lartë.

Në arsimin pas të mesëm jo të lartë u diplomuan 85 persona, prej të cilëve 24,7 % femra dhe 75,3 % meshkuj. Fushat në të cilat u diplomuan janë: “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, “Diagnostikim-menaxhim në autoservis” dhe “Dizajn dhe Modë”.

Fig. 1 Nxënës të diplomuar në arsimin 9 vjeçar sipas gjinisë




Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, INSTAT

Arsimi i lartë

Në vitin akademik 2023-2024, u diplomuan në arsimin e lartë 28.193 studentë. Studentët e diplomuar në programet “Bachelor” përbëjnë 51,3 % e studentëve të diplomuar gjithsej, ndjekur nga programet “Master” me 43,1 %. Në të gjithë programet e arsimit të lartë, në këtë vit akademik, u diplomuan 18.555 studente femra, ose 65,8 % e numrit të përgjithshëm të studentëve të diplomuar në arsimin e lartë.

Fig. 2 Të diplomuar në arsimin e lartë sipas programeve të studimit dhe gjinisë, 2023-2024




Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, INSTAT

Fusha në të cilën janë diplomuar më shumë studentë në të gjitha programet është “Biznes, administrim dhe ligj” prej 24,4 % ose rreth një e katërta e numrit të përgjithshëm të të diplomuarve. Analiza për secilën fushë të studimeve tregon se femrat në krahasim me meshkujt janë diplomuar më shumë në

“Shkenca sociale, gazetari dhe informacion” (83,0 %), ndjekur nga “Shkenca arsimi” (81,7 %) dhe “Shëndet dhe mirëqenie” (78,9 %). Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë meshkujt krahasimisht me femrat janë “Shërbime” (67,3 %), “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim” (63,1 %) dhe “Teknologji e informacionit dhe komunikimit” me (56,2 %).

Fig. 3 Të diplomuar në arsimin e lartë sipas fushës së studimit dhe gjinisë, 2023-24



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, INSTAT

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <https://www.instat.gov.al/>

Aneks:**Tab.1 Nxënës të diplomuar në arsimin parauniversitar**

ISCED-2011	Niveli arsimor	2021-22			2022-23			2023-24		
		Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
1+2	Në arsimin 9 vjeçar	14.346	15.565	29.911	13.512	14.976	28.488	13.458	14.247	27.705
3	Në arsimin e mesëm	15.080	14.423	29.503	14.295	12.774	27.069	13.896	12.833	26.729
	<i>Gjimnaz dhe Social-Kulturor</i>	14.386	11.441	25.827	13.726	10.131	23.857	13.347	10.208	23.555
	<i>Profesional</i>	694	2.982	3.676	569	2643	3.212	549	2.625	3.174
4	Në arsimin pas të mesëm, jo të lartë	-	-	-	-	-	-	21	64	85

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Tab. 2 Studentë të diplomuar në arsimin universitar

ISCED-2011	Niveli arsimor	2021-22			2022-23			2023-24		
		Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
5	Programe 2 vjeçare	816	846	1.662	743	841	1.584	710	826	1.536
6	Bachelor	10.455	5.562	16.017	8.731	5.077	13.808	9.395	5.080	14.475
7	Master	9.046	3.916	12.962	8.708	3.775	12.483	8.433	3.718	12.151
8	Doktoraturë	172	97	269	59	57	116	17	14	31
	Gjithsej	20.489	10.421	30.910	18.241	9.750	27.991	18.555	9.638	28.193

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit

Tab. 3 Studentë të diplomuar në arsimin universitar sipas fushave të studimit

Niveli arsimor	2021-22			2022-23			2023-24		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Shkenca arsimit	2.580	630	3.210	2.047	430	2.477	1.867	418	2.285
Arte dhe shkenca humane	2.183	541	2.724	1.602	441	2.043	1.488	442	1.930
Shkenca sociale, gazetari dhe informacion	2.344	629	2.973	2.075	528	2.603	2.211	454	2.665
Biznes, administrim dhe ligj	5.639	2.779	8.418	4.734	2.367	7.101	4.808	2.080	6.888
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	791	243	1.034	658	159	817	518	152	670
Teknologji e informacionit dhe komunikimit	785	1.093	1.878	822	1.160	1.982	991	1.271	2.262
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	1.305	2.216	3.521	1.315	2.192	3.507	1.421	2.431	3.852
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar	536	553	1.089	442	474	916	383	362	745
Shëndet dhe mirëqenie	3.927	1.002	4.929	4.169	1.167	5.336	4.462	1.191	5.653
Shërbime	399	735	1.134	377	832	1.209	406	837	1.243
Gjithsej	20.489	10.421	30.910	18.241	9.750	27.991	18.555	9.638	28.193

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit

Metodologjia

Nivelet e arsimit në Shqipëri janë të organizuar sipas programeve dhe të klasifikuar sipas Klasifikimit ISCED-2011 i cili përdoret ndërkombëtarisht në statistikën e arsimit, si në vijim:

- Niveli 0 - Arsimi parashkollor: çerdhe/kopshte
- Niveli 1 - Arsimi fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë
- Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë
- Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë :Gjimnaz / Profesional / Social kulturor
- Niveli 4 - Arsimi pas të mesmes, jo i lartë
- Niveli 5 - Arsimi i lartë, cikël i shkurtër
- Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent
- Niveli 7 - Master ose ekuivalent
- Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

Përkufizime:

Arsimi zyrtar është përcaktuar si arsimi i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe i planifikuar, përmes institucioneve publike dhe private, të njohura (licensuara) nga autoriteti kombëtar arsimor, të cilët në tërësinë e tyre përbëjnë sistemin arsimor zyrtar të një vendi. Programet e arsimit zyrtar janë të njohura si të tilla nga autoritetet përkatëse të arsimit kombëtar, ato ekuivalente ose vartëse të tij. Arsimi zyrtar konsiston më tepër në arsimin që fillon nga klasa e parë dhe vazhdon rregullisht vit pas viti, kryesisht në sistemin pa shkëputje nga puna ose me kohë të plotë (përpara se të bëhen pjesë e tregut të punës), në atë profesional, arsimin për nevojë të veçanta dhe disa pjesë të arsimit për të rritur, shpesh të njohura si pjesë e sistemit arsimor zyrtar.

Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë, përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor, i cili kryhet në klasat 1-5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët, i cili kryhet në klasat 6-9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi ka detyrimin të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.

Arsimi i mesëm përfshin gjimnazin, atë social-kulturor dhe arsimin profesional, cili ndahet në të ulët teknik dhe të lartë.

Arsimi profesional përfshin programet e arsimit të hartuara me qëllim përfitimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave specifike për një profesion të veçantë ose klasë të profesioneve.

I diplomuar në një program arsimor është një nxënës ose student, i cili ka përfunduar në mënyrë të suksesshme të gjitha kërkesat e programit.

Të dhënat mbi statistikën e diplomimeve janë subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: https://www.instat.gov.al/media/2940/revision_policy_2016.pdf, Politika e revizionimit statistikor.

Burimi i të dhënave:

Të dhënat e statistikave të arsimit sigurohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me periodicitetet vijtor.